VENDIM
Nr. 485, datë 24.7.2024

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën "ç", të pikës 1, të kreut I, pas emërtesës "Komiteti Shtetëror i Kulteve" shtohet "Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit";

b) Në lidhjen nr. 10:

i. Pas emërtesës "Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile" shtohet emërtesa "Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit";

ii. Pas emërtesës "Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës publike (ASPA)" shtohet emërtesa "Specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit/transferimit të nëpunësit në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për institucionin për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku